

PORSCHE
HOLDING

KODI YNË I

SJELLJES



PËRMBAJTJA

NE VEPROJMË SI NJË E TËRË

JEMI TË PËRKUSHTUAR EDHE SI INDIVIDË

- 1.1 Të drejtat e njeriut
- 1.2 Lidërshipi etik
- 1.3 Diversiteti, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrja e barabartë
- 1.4 Liria e fjalës
- 1.5 Përfaqësimi i të punësuarve

JEMI KOLEGË TË BESUESHËM

- 2.1 Shëndeti dhe siguria në punë
- 2.2 Trajtimi i pasurive të kompanisë
- 2.3 Siguria dhe mbrojtja e informacionit, njohurive dhe pronës intelektuale


NE JEMI PARTNERË TË PËRGJEGJSHËM

- 3.1 Konfliktet e interesit
- 3.2 Benefitet
- 3.3 Ndalimi i korrupsionit
- 3.4 Ndalimi i tregtisë në bazë të informacioneve të brendshme
- 3.5 Ndalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- 3.6 Konkurrenca e ndershme dhe e lirë
- 3.7 Partnerët e biznesit, prokurimi dhe shitjet
- 3.8 Kontabiliteti dhe raportimi financiar
- 3.9 Kontrolli i eksportit

NE JEMI QYTETARË KORPORATIVË TË MIRË

- 4.1 Komunikimi dhe marketingu
- 4.2 Lobimi politik
- 4.3 Marrëdhëniet me zyrtarët publikë
- 4.4 Donacionet dhe sponsorizimi social
- 4.5 Tatimet dhe taksat doganore
- Mbrojtja e të dhënave
- 4.7 Siguria informatike
- 4.8 Përputhshmëria e produkteve
- 4.9 Mbrojtja e mjedisit natyror

MBËSHTETJA



BAZAT E GRUPIT

Bazat e Grupit janë vlerat tona, të cilat lidhin të gjithë njerëzit nëpër të gjitha brendet dhe kompanitë. Ato krijojnë themelin të kulturës sonë korporative.



Marrim përsipër përgjegjësi për mjedisin dhe shoqërinë.

Jemi të singertë dhe flasim haptas kur diçka nuk është në rregull.



Krijojmë një terren të ri.



Përjetojmë diversitetin.



Jemi krenarë për punën që e bëjmë.



Ne, jo unë.



E mbajmë fjalën tonë.

NE JEMI NJË E TËRË

Bazat tona të integritetit
dhe pajtueshmërisë

Veprojmë si një e tërë

Kodi i Sjelljes i Grupit Porsche Holding, KODI YNË, është themeli etik dhe vlerësor për të vepruar me integritet dhe në pajtim me rregullat e Grupit tonë. Ai shërben si një udhëzues i detyrueshëm për të gjithë të punësuarit e të gjitha brendeve dhe kompanive në gjithë botën.

Së bashku, ne mbajmë përgjegjësi për bashkëpunimin tonë, vendin e punës, mjedisin, qëndrueshmërinë dhe shoqërinë. Ne trajtojmë njëri-tjetrin dhe të gjithët përreth nesh me respekt, si njerëz të barabartë me ne. Ne mbajmë qëndrimin tonë, jemi të palëkundur dhe të guximshëm në mbrojtjen

e vlerave të parimeve tona – pavarësisht nga koha dhe presioni ekonomik apo shoqëror.

Ne besojmë fuqimisht se është domosdoshme që secili prej nesh – të punësuarit, anëtarët e bordit dhe menaxherët – të veprojmë me ndershmëri në mënyrë që të kultivojmë besimin në kompaninë tonë, si edhe në produktet, shërbimet dhe inovacionet tona. Kjo është arsyeja pse vendimet që i marrim në të gjitha rolet dhe funksionet duhet të jenë në pajtim me vlerat tona korporative, si edhe me ligjet, rregulloret dhe detyrimet vullnetare të brendshme në nivel si kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Kjo vlen edhe për zhvillimin e vazhdueshëm të kompanisë sonë, si

zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive inovative siç është intelijenca artificiale.

6

Transparenca është e rëndësishme për ne dhe qasja jonë në teknologjitë inovative siguron respektimin e të drejtave dhe sigurisë së përdoruesve.

Ne nuk tolerojmë shkeljet e Kodit të Sjelljes. Kushdo që i shkel rregulloret tona duhet të presë pasojat përkatëse. Për të parandaluar që kjo të ndodhë, ne kërkojmë këshilla dhe mbështetje për të mbrojtur së bashku kompaninë tonë, vlerat e saj dhe reputacionin e të gjitha brendeve.

Secili prej nesh është personalisht përgjegjës për respektimin e **KODIT TONË**. Ne duhet të familjarizohemi me parimet e Kodit në mënyrë që ai të na udhëheqë në vendimet tona të përditshme. Për hir të veprimtarisë së Grupit, për mbrojtjen e njerëzve dhe mjedisit dhe për të mirën e brezave të ardhshëm.

WE ARE ONE

JEMI TË PËRKUSHTUAR SI INDIVIDË

Ne pranojmë vlerat, parimet dhe politikat tona korporative, duke promovuar kështu një ndërveprim të besueshëm, të ndershëm dhe të drejtë me njëri-tjetrin. Ne të gjithë jemi modele të sjelljes.



- 1.1 Të drejtat e njeriut
- 1.2 Lidhshipi etik
- 1.3 Diversiteti, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrja e barabartë
- 1.4 Liria e fjalës
- 1.5 Përfaqësimi i të punësuarve

1.1 Të drejtat e njeriut

Ne pranojmë përgjegjësinë për të drejtat e njeriut

PARIMI KORPORATIV

Respektimi i të drejtave të njeriut është i një gjë thelbësore. Ne jemi të bindur se aktiviteti ekonomik i qëndrueshëm është i mundur vetëm nëse sillemi në mënyrë etike dhe me integritet. Në kuadër të aktiviteteve tona sipërmarrëse, ne jemi plotësisht të përkushtuar ndaj përgjegjësisive tona lidhur me të drejtat e njeriut. Bordi i Drejtorëve të Grupit, Këshilli Evropian i të Punësuarve të Grupit Porsche Holding dhe Këshilli Global i të Punësuarve të Grupit Volkswagen kanë përmbyshur këtë përgjegjësi përmes Deklaratës së Grupit për të Drejtat Sociale, Marrëdhëniet Industriale dhe Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, të njohur si Karta Sociale.

Ne konfirmojmë angazhimin tonë për marrëveshjet dhe deklaratat kryesore ndërkombëtare, në veçanti për Ligjin Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat e Njeriut dhe standardet kryesore të punës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Aktivitetet tona sipërmarrëse janë në pajtim me parimet e Kombeve të Bashkuara lidhur me biznesin dhe të drejtat e njeriut (UN Global Compact), të cilat përcaktojnë bazat e biznesit tonë.

KONTRIBUTI IM

Si i punësuar, unë mund të kontribuoj në respektimin e të drejtave të njeriut.

Unë konsideroj se të drejtat e njeriut janë një udhëzues themelor dhe jam kundër ndonjë shkeljeje të të drejtave të njeriut që ndodh rreth meje ose për të cilat jam në dijeni.

Nëse unë vë re ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut në mjedisin tim profesional, unë do ta parandalojë ose do ta ndalë menjëherë. Nëse është e nevojshme, unë do ta informoj mbikëqyrësin tim ose do të kontaktoj ndonjë nga personat e kontaktit të përmendur në kapitullin "Mbështetja".

punësuarve të furnizuesit janë nën rrogën minimale.

SHEMBULL

Dikush ju ka informuar se një nga furnizuesit tanë nuk u paguan të punësuarve rrogat dhe se ai e shkel ligjin e punës, duke toleruar një javë pune prej 80 orësh. Për më tepër, rrogat e disa prej të

Informoni Sistemin e denoncimit përmes
eporëve tuaj lidhur me shkeljen e të drejtave të

njeriut. Kompania jonë do të shqyrtojë denoncimin në
mënyrë të detajuar dhe do të marrë masat e
nevojshme. Kjo mund të përfshijë ndërprerjen e
marrëdhënieve të biznesit me furnizuesin në fjalë.



1.2 Lidershipi etik

Vlerat tona janë ajo që na udhëheq

PARIMI KORPORATIV

Ne pranojmë vlerat, parimet dhe politikat tona korporative, marrim përgjegjësi për rritjen personale dhe korporative dhe udhëheqim me shembull. Kryejmë detyrat tona dhe menaxhojmë kompetencat dhe rolet tona në mënyrë të drejtë dhe të përgjegjshme. Kjo vlen edhe për marrëdhëniet personale në vendin e punës, duke marrë parasysh që punësimi ekzistues dhe varësitë hierarkike mund të keqpërdoren. Vendimet tona janë gjithmonë transparente, tregojnë gjykim të mirë, udhëhiqen nga integriteti dhe merren në interesin më të mirë të kompanisë, të punësuarve, partnerëve të biznesit dhe aksionarëve të saj. Ne përforcojmë besimin e ndërsjellë dhe formësojmë ndryshimet në kompani përmes lidershipit tonë të bazuar në vlera.

KONTRIBUTI IM

Unë jam i vetëdijshëm/e vetëdijshme për shembullin që unë e jap si në Kompani ashtu edhe në kontekstin më të gjerë. Sjellja dhe veprimet e mia udhëhiqen gjithmonë nga integriteti dhe ndjenja e përgjegjësive, dhe bazohen në këtë Kod të Sjelljes, si edhe në vlerat, parimet dhe politikat tona korporative. Unë jam i/e angazhuar për të bashkëvepruar me të tjerët në frymë të besimit, ndershmërisë dhe drejtësisë dhe jam i/e hapur ndaj pikëpamjeve të ndryshme.

SHEMBULL

Për të përfunduar një projekt në kohën e parashikuar, ekipi juaj ka ndërmend të kapërcejë një hap në proces. Ata thonë se ky hap është i panevojshëm.

Ju do të theksoni se duhet të ndiqen rregullat e vlefshme, pavarësisht nga presionet e mundshme. Së bashku, do të kërkonti një zgjidhje në pajtim me kërkesat dhe vlerat tona. Ju angazhoheni të rishikoni procesin në bashkëpunim me të gjitha palët e përfshira dhe, nëse është e mundur, të kurseni kohë. Ju do të angazhoheni për këtë si menaxher dhe anëtar i ekipit.

1.3 Diversiteti, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrja e barabartë

Përrjetojmë diversitetin

PARIMI KORPORATIV

Diversiteti, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrja e barabartë janë parime të rëndësishme për një bashkëjetesë të drejtë dhe jo-diskriminuese. Ne besojmë në bashkëpunimin në frymë të partneritetit, tolerancës dhe respektit të ndërsjellë. Ne kultivojmë diversitetin në kuadër të personelit tonë dhe mbështesim një mjedis pune gjithëpërfshirës.

Ne ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë dhe hedhim poshtë të gjitha format e diskriminimit.

Kjo vlen në veçanti për trajtimin e pabarabartë pavarësisht nga origjina etnike ose sociale, ngjyra, gjinia biologjike, kombësia, gjuha, feja, ideologjia, mosha, mangësitë fizike ose mendore, identiteti gjinor, orientimi seksual, pikëpamjet politike dhe ndonjë karakteristike tjetër të mbrojtur me ligj. Ne përjetojmë diversitetin, mbështesim aktivisht inkluzivitetin dhe krijojmë një mjedis që jo vetëm inkurajon angazhimin e të gjithë të punësuarve, por gjithashtu kultivon individualitetin e secilit të punësuar në interes të kompanisë.

Të punësuarit tanë zgjidhen, rekrutohen dhe trajnohen në bazë të kualifikimeve dhe aftësive të tyre.

KONTRIBUTI IM

Unë respektoj parimet e diversitetit, mundësitë të barabarta dhe pjesëmarrjes së barabartë dhe i inkurajoj njerëzit rreth meje që të bëjnë të njëjtën gjë.

Nëse unë vë re ndonjë shkelje të parimeve të mundësive të barabarta dhe pjesëmarrjes së barabartë, të tilla si trajtimi i pabarabartë, ngacmimi dhe keqtrajtimi, unë i informoj eprorët e mi këtë sjellje të keqe. Nëse nuk jam në mundësi të ndikoj drejtpërdrejt në ngjarje, unë e njoftoj menjëherë departamentin e burimeve njerëzore për incidentin ose kontaktoj ndonjë nga personat e kontaktit të përmendur në kapitullin "Mbështetja".

SHEMBULL

Ju i keni dëgjuar njerëzit me të cilët punoni se si ata bëjnë komente mosrespektuese për njerëz të tjerë në bazë të kombësisë, gjinisë, orientimit seksual ose ngjyrës së lëkurës.

Flisni haptas për këtë diskriminim ose kontaktini menjëherë një nga personat e kontaktit të përmendur në kapitullin "Mbështetja".

1.4 Liria e fjalës

Ne flasim haptas, kur diçka nuk është në rregull

PARIMI KORPORATIV

Ne duam të mësojmë nga gabimet dhe të përmirësohemi vazhdimisht. Kjo është arsyeja pse ne flasim për veprimet e gabuara dhe informojmë kur diçka nuk është në rregull, edhe në qoftë se kjo mund të jetë e pakëndshme. Për ta bërë këtë, ne promovojmë një kulturë integriteti dhe inkurajojmë në mënyrë aktive dialogun brenda ekipit tonë dhe me mbikëqyrësit tanë. Ne kërkojmë këshilla dhe mbështetje nëse kemi pyetje ose probleme. Ne mbrojmë të gjithë ata që kontribuojnë në këtë kulturë.

Pajtueshmëria me rregullat e jashtme dhe të brendshme është një gjë e padiskutueshme për ne në çdo kohë. Ne nuk tolerojmë asnjë sjellje të pahijshme. Ne besojmë se mbyllja e syve ndaj problemeve nuk mund të çojë kurrë në zgjidhjen e tyre. Kjo është arsyeja pse ne reagojmë menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme ndaj sjelljeve të gabuara dhe shkeljeve të rregulloreve tona.


Menaxherët japin gjithmonë shembull, duke u sjellë në pajtim me rregullat dhe rregulloret tona. Ata e kryejnë këtë funksion aq të rëndësishëm, duke i mbështetur të punësuarit në mënyrë që ata t'u përmbahen rregullave, duke promovuar kulturën e pranimit të gabimeve dhe duke

KONTRIBUTI IM

Pika ime e parë e kontaktit për pyetje, shqetësime ose dyshime të arsyeshme lidhur me shkeljen e rregulloreve të brendshme ose të jashtme është mbikëqyrësi im, ose përndryshe unë mund të kërkoj këshilla nga ekspertët përkatës. Departamenti i Burimeve Njerëzore, përfaqësuesit e të punësuarve dhe Departamenti i Pajtueshmërisë janë gjithashtu në dispozicion për të ofruar mbështetje. Për më tepër, unë duhet të raportoj çdo dyshim të arsyeshëm për shkelje serioze të rregulloreve përmes sistemit të denoncimit. Si punëmarrës në nivel menaxhmenti, jam në detyrë të raportoj çdo dyshim të tillë.

SHEMBULL

Afati i dhënë komisionit për të propozuar një vendim ka përfunduar dhe ju keni vënë re se ju dhe ekipi juaj keni bërë një gabim. Ju e dini që nuk mund të merret një vendim



kuptimplotë bazuar në të dhënat në dispozicion

Informoni menjëherë eprorin tuaj dhe departamentet që përgjigjen për komisionin. Gjeni një mënyrë për të korrigjuar dokumentin së bashku. Përveç kësaj, ju dhe ekipi juaj duhet të diskutoni se si mund të parandalohen gabime të tilla në të ardhmen.

14

1.5 Përfaqësimi i të punësuarve

Ne punojmë së bashku, si partnerë të ngushtë— në mënyrë konstruktive, bashkëpunuese dhe të drejtë

Ne pranojmë të drejtën themelore të të gjithë të punësuarve për të krijuar sindikata dhe organe përfaqësuese të të punësuarve.

Ne jemi të përkushtuar për të bashkëpunuar me përfaqësuesit e të punësuarve, në mënyrë të sinqertë dhe të besueshme, si edhe për të zhvilluar një dialog konstruktiv dhe bashkëpunues me ta me qëllim për të siguruar ekuilibrin e drejtë të interesave. Marrëdhëniet profesionale me përfaqësuesit e të punësuarve janë pjesë e kulturës sonë korporative.

Ruajtja e ardhmërisë së Grupit dhe të punësuarve të tij realizohet në frymë të menaxhimit bashkëpunues të konflikteve dhe angazhimit social, me qëllim për të siguruar konkurrueshmërinë ekonomike dhe teknologjike. Efikasiteti ekonomik dhe mbrojtja e vendeve të punës janë qëllime të përbashkëta njëjloj të rëndësishme.

JEMI KOLEGË TË BESUESHËM

Ne e marrim seriozisht përgjegjësinë tonë në vendin e punës dhe mbrojmë atë që ka vlerë për ekipin tonë, kompaninë tonë dhe blerësit tanë.



- 2.1 Shëndeti dhe siguria në punë
- 2.2 Trajtimi i pasurive të kompanisë
- 2.3 Siguria dhe mbrojtja e informacionit,
njohurive dhe pronës intelektuale

2.1 Shëndeti dhe siguria në punë

Ne respektojmë dhe promovojmë shëndetin dhe sigurinë

PARIMI KORPORATIV

Ne e marrim shumë seriozisht përgjegjësinë tonë për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve tanë. Ne promovojmë shëndetin dhe sigurinë në punë në pajtim me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, si edhe me politikën e shëndetit dhe sigurisë në punë të Kompanisë.

Shëndeti dhe siguria në punë për të gjithë të punësuarit është thelbësore për të siguruar një ardhshmëri të qëndrueshme për kompaninë tonë dhe gjithashtu për ta pozicionuar kompaninë tonë si një punëdhënës tërheqës. Të gjitha aksidentet dhe sëmundjet e lidhura me punën janë të parandalueshme në përgjithësi. Prandaj, ne synojmë të sigurojmë mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor, gjë që kërkon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e të gjithëve.

KONTRIBUTI IM

Unë u përmbahem rregulloreve dhe udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë në punë. Unë nuk e rrezikoj shëndetin dhe sigurinë time ose shëndetin dhe sigurinë e ekipit tim ose të palëve të treta. Unë i mbështes, nuk e injoroj padrejtësinë dhe pranoj ndihmë.

Brenda fushës sime të përgjegjësisë, unë marr të gjitha masat ligjore të duhura për të siguruar një mjedis të sigurt pune. Unë tërheq gjithmonë vëmendjen për veprime ose kushte të pasigurta.

Unë kontribuoj aktivisht në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit tim, duke marrë pjesë vullnetarisht në aktivitete parandaluese për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit. Unë u përmbahem udhëzimeve, marr pjesë në trajnime dhe kryej veprimet e mia të përditshme në pajtim me këto udhëzime.

SHEMBULL

Ju keni vënë re se një pajisje në departamentin tuaj ka një defekt elektrik.

Mos e ndizni pajisjen dhe informoni personin kompetent për të koordinuar masat e mëtejshme. Nuk lejohet riparimi i pajisjeve elektrike në mënyrë të pavarur, pasi kjo mund të jetë e rrezikshme.

2.2.Trajtimi i pasurisë së kompanisë

Ne mbrojmë pasuritë tona – të dukshme dhe të padukshme

PARIMI KORPORATIV

SHEMBULL

Ne respektojmë pasuritë e prekshme dhe të paprekshme të kompanisë dhe nuk i përdorim ato për qëllime të tjera, por ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve të biznesit të kompanisë. Përrjashtimet janë të mundshme vetëm në qoftë se politikat dhe udhëzimet e brendshme lejojnë përdorimin privat.

20

KONTRIBUTI IM

Unë u përmbahem rregullave të kompanisë dhe i trajtoj pasuritë e saj me kujdes.

Bija juaj ju pyet nëse mund t'i sillni letër dhe stilolapsa nga zyra, sepse ajo ka dëshirë t'i përdorë në shkollë.

Ju duhet t'i shpjegoni se nuk ju lejohet të përdorni artikuj zyre nga puna për qëllime personale.

2.3. Siguria dhe mbrojtja e informacionit, njohurive dhe pronës intelektuale

Ne mbrojmë informacionin dhe pronën intelektuale

PARIMI KORPORATIV

Ne jemi të vetëdijshëm për vlerën e njohurive të kompanisë dhe kujdesemi shumë për t'i mbrojtur. Ne respektojmë pronën intelektuale të konkurrentëve, partnerëve të biznesit dhe palëve të treta.

KONTRIBUTI IM

Unë i trajtoj me kujdes të gjitha informacionet e kompanisë dhe nuk ua zbuloj personave të paautorizuar. I kushtoj vëmendje të veçantë informacionit lidhur me njohuritë teknike, patentat dhe sekretet tregtare.

SHEMBULL

Së shpejti, shpikja juaj teknike do të hyjë në prodhim në seri. Ju keni ndërmend të flisni për të me një koleg, kur të takoheni në tren për në shtëpi.

Kini parasysh se idetë dhe patentat janë pronë intelektuale e kompanisë dhe nuk duhet të diskutohen në publik. Nëse keni ndonjë dyshim, ju lutemi kontaktoni mbikëqyrësin tuaj ose departamentin përkatës.



JEMI PARTNERË TË PËRGJEGJSHËM

Besimi është pasuria jonë më e madhe. Kjo është arsyeja pse ne mbështetemi në marrëdhënie biznesi të të besueshme, transparente dhe të drejta.



- 3.1 Konfliktet e interesit
- 3.2 Benefitet
- 3.3 Ndalimi i korrupsionit
- 3.4 Ndalimi i tregtisë në bazë të informacioneve të brendshme
- 3.5 Ndalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- 3.6 Konkurrenca e ndershme dhe e lirë
- 3.7 Partnerët e biznesit, prokurimi dhe shitjet
- 3.8 Kontabiliteti dhe raportimi financiar
- 3.9 Kontrolli i eksportit

3.1 Konfliktet e interesit

Ne marrim vendime në bazë të fakteve dhe kështu shmangim konfliktet e interesit



PARIMI KORPORATIV

Ne veprojmë me integritet. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme për ne që të shmangim paraqitjen e konflikteve të interesit gjatë kryerjes së detyrave tona të punës dhe të identifikojmë dhe zbulojmë konfliktet e mundshme me të cilat përballemi ose hasemi. Konflikti i interesit ekziston në këto raste, kur interesat financiare private ose personale të të punësuarve ndikojnë ose mund të ndikojnë në vendimet e tyre të biznesit. Kjo vlen edhe për marrëdhëniet personale në vendin e punës lidhur sidomos me marrëdhëniet ekzistuese të punësimit dhe varësitë hierarkike.

Konfliktet e interesit mund të paraqiten si nga ana e të punësuarve ashtu edhe nga ana e personave të lidhur me ta, veçanërisht si rezultat i angazhimit në kompani të tjera si punësim dytësor, ose lidhur me anëtarësinë në një organizatë ose si pasojë situatës materiale personale të të punësuarve. Në këtë kontekst, marrëdhëniet e biznesit me palët e treta, siç janë kompanitë e tjera të Grupit ose furnizuesit, mund të jenë gjithashtu të rëndësishme.

KONTRIBUTI IM

Nëse zbuloj se po përballem ose dyshoj se mund të përballem me një konflikt interesi, unë do ta njoftoj menjëherë mbikëqyrësin tim, departamentin e burimeve njerëzore dhe departamentin e pajtueshmërisë, duke u zbuluar faktet që kam në dijeni. Nëse ekziston një konflikt interesi, ne do të kërkojmë së bashku një zgjidhje që mbrohet interesat e kompanisë.

SHEMBULL

Ju punoni në departamentin e prokurimit dhe keni shpallur një tender. Ju vini re se shoku juaj më i mirë ka aksione në një nga kompanitë që kanë paraqitur një ofertë.

Informoni mbikëqyrësin tuaj për situatën, dokumentoni konfliktin e mundshëm të interesit dhe tërhiquni nga procesi i vendimmarrjes për të shmangur çdo konflikt interesi.

3.2 Benefitet

Verifikojmë me kujdes të gjitha benefitet

PARIMET KORPORATIVE

Produktet dhe shërbimet tona përcaktojnë se kush jemi. Prandaj, benefitet në formë të dhuratave dhe ftesave lejohen vetëm nëse ato janë të përshtatshme.

Politikat tona të brendshme për trajtimin e dhuratave, ftesave dhe vakteve të biznesit përcaktojnë se cilat benefite janë të përshtatshme dhe cilët hapa duhet të ndërmerren gjatë pranimit dhe/ose miratimit të tyre.

KONTRIBUTI IM


Unë jam i njohur me politikën e dhuratave, ftesave dhe vakteve të biznesit dhe i përmbahem në mënyrë rigorozë.

Unë do të verifikoj nëse sjellja ime është e përshtatshme dhe mund të ndikojë në vendimet e mia të biznesit.

SHEMBULL

Të punësuarit e një partneri të biznesit ju japin një kufje Bluetooth si dhuratë për ditëlindjen tuaj. Edhe në qoftë se jeni i/e sigurt se pranimi i kësaj dhurate nuk do të ndikojë në marrëdhëniet e biznesit, duhet të konsideroni në mënyrë kritike sa e përshtatshme është kjo dhuratë bazuar në politikën e benefiteve në fuqi.

Nëse keni dyshime, kërkoni këshilla nga mbikëqyrësi juaj dhe vendosni së bashku nëse do ta pranoni ose refuzoni dhuratën.



3.3 Ndalimi i korrupsionit

As nuk u japim ryshfet të tjerëve, as nuk pranojmë ryshfet

PARIMET KORPORATIVE

Korrupsioni është i ndaluar në gjithë botën. Korrupsioni do të thotë që dikush e keqpërdor pozicionin e vet profesional për të fituar një avantazh për veten ose një palë të tretë dhe në këtë mënyrë i dëmtojë të tjerët.


Benefitet e tilla si ftesat dhe dhuratat, sidomos kur bëhet fjalë për nëpunësit publikë, mund të jenë dëshmi e korrupsionit. Për këtë arsye, benefitet duhet të jenë përjashtime në transaksionet e biznesit. Benefitet mund të jepen ose të pranohen vetëm në kuadër të politikave të brendshme dhe ligjeve në fuqi.

KONTRIBUTI IM

Unë nuk u jap ryshfet të tjerëve dhe personalisht nuk marr ryshfet. Unë madje parandaloj situata të tilla kur mund të paraqitet një ndikim i papërshtatshëm. Unë informohem për rregullat e brendshme para se të jap ose të pranoj dhurata dhe ftesa.

Nëse kam ndonjë dyshim lidhur me korrupsionin, unë njoftoj menjëherë një nga personat e kontaktit të përmendur në kapitullin "Mbështetja".

SHEMBULL



29

3.4 Ndalimi i tregtisë në bazë të informacioneve të brendshme

Ne nuk ndajmë njohuritë tona të brendshme

PARIMI KORPORATIV

Ju punoni në zhvillimin e softuerit dhe duhet t'i caktoni një nënprojekt të madh një furnizuesi të jashtëm të shërbimeve. Një nga furnizuesit e shërbimeve të ftuar për të paraqitur një ofertë ju ofron një shumë të madhe parash në qoftë se do të siguroheni që kompania e tij ta marrë porosinë.

Sjellja e furnizuesit të shërbimeve përbën një përpjekje korrupsioni. Kontaktoni menjëherë mbikëqyrësin tuaj ose departamentin përkatës të pajtueshmërisë.

Ne menaxhojmë informacionet lidhur me rezultatet e Kompanisë në pajtim me kërkesat e tregut të kapitaleve dhe nuk tolerojmë tregtinë në bazë të informacioneve të privileguara. Informacioni i brendshëm është informacion i saktë, i cili nuk është bërë publik, por në qoftë se bëhet publik, ka të ngjarë të ketë një ndikim të rëndësishëm në çmimin e instrumentit financiar përkatës, siç janë, për shembull, aksionet. Ne mund të përdorim njohuritë lidhur me projekte dhe procese të brendshme të rëndësishme vetëm në pajtim me politikën e brendshme të zbatueshme dhe nuk mund t'u zbulojmë këto njohuri palëve të jashtme, duke përfshirë anëtarët e familjes, siç është, për shembull, bashkëshorti.

KONTRIBUTI IM

Unë nuk merrem me tregtinë në bazë të informacioneve të brendshme, as nuk bëj rekomandime të tilla palëve të treta, as nuk i inkurajoj palët e treta që të merren me tregtinë në bazë të informacioneve të brendshme. Për më tepër, unë nuk zbuloj informacione të brendshme përveç rastit kur kjo është e domosdoshme për punën time të rregullt dhe u përmbahem politikave të brendshme përkatëse. Unë marr përsipër të familjarizohem me rregullat e brendshme në fuqi.

Nëse kam qasje në informacione të brendshme, unë nuk do të blej ose shes asnjë instrument financiar në bazë të këtij informacioni. Kjo vlen jo vetëm për tregtimin e aksioneve të kompanive të përmendura që i përkasin Grupit ose derivateve të tyre, por edhe për tregtimin e instrumenteve financiare në përgjithësi, duke përfshirë ato të furnizuesve.

SHEMBULL

Përmes punës suaj, ju keni marrë vesh se së shpejti do të shpallet blerja e një kompanie të madhe të njohur në gjithë botën. Ju jeni informuar se çmimi i aksioneve të kompanisë do të rritet shumë pasi të shpallet ky transaksion. Ju e dini që një miku juaj i mirë do të shesë aksionet e veta në kompaninë tonë. Ju keni ndërmend t'i thoni mikut tuaj se ai duhet të heqë dorë nga shitja e aksioneve.

Mos i jepni këshilla mikut tuaj në asnjë mënyrë. Duke marrë parasysh se ky informacion nuk është publik, ai është një njohuri e brendshme dhe prandaj, nuk ju lejohet në asnjë rrethanë të ndani këtë informacion me të tjerët. Transmetimi i kësaj njohurie drejtpërdrejt ose tërthorazi përbën një shkelje

3.5 Ndalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Jemi të përkushtuar për biznese të pastra

PARIMI KORPORATIV

Pastrimi i parave ndodh kur në ekonominë e ligjshme vihen në qarkullim fonde ose pasuri të tjera, të cilat burojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga vepra penale, në mënyrë që burimi i tyre të duket i ligjshëm. Financimi i terrorizmit ndodh kur paratë ose burimet e tjera vihen në dispozicion për të kryer vepra terroriste ose për të mbështetur organizata terroriste. Përgjegjësia nuk parashikon domosdo që personi i përfshirë duhet të jetë i vetëdijshëm se paratë pastrohen përmes transaksionit përkatës. Pjesëmarrja e paqëndrueshme në pastrimin e parave mund të përbëjë një veprë penale për palët e përfshira.

Ne verifikojmë me kujdes identitetin e klientëve, partnerëve të biznesit dhe palëve të treta të tjera, me të cilat duam të bëjmë biznes. Qëllimi ynë i deklaruar është të veprojmë ekskluzivisht me partnerë me reputacion të mirë, të cilët veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore dhe përdorin mjete nga burime të ligjshme.

Ne dërgojmë pagesat hyrëse në shërbimet përkatëse pa vonesë dhe i postojmë në pajtim me rrethanat. Ne sigurojmë rrjedha monetare

KONTRIBUTI IM

Unë nuk ndërmarr asnjë veprim që mund të cenojë dispozitat për pastrimin e parave brenda ose jashtë vendit. Unë kam kujdes dhe vlerësoj menjëherë çdo sjellje të dyshimtë të klientëve, partnerëve të biznesit dhe palëve të treta. Nëse ka informacion të mjaftueshëm për të dyshuar, unë e kontaktoj menjëherë personin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave.

Unë u përmbahen të gjitha dispozitave në fuqi lidhur me regjistrimin dhe postimin e transaksioneve dhe kontratave nga fusha ime e përgjegjësisë në sistemin e kontabilitetit.

transparente dhe të hapura


SHEMBULL

Një klient dëshiron të lidhë një kontratë financimi, por refuzon të dorëzojë disa nga dokumentet e zakonshme që janë të nevojshme për të plotësuar dokumentacionin financiar.

Dokumentet janë të nevojshme për të lidhur kontratën e financimit. Nëse nuk dorëzohen dokumente të tilla si

akti i vetëzbulimit ose nuk paraqitet asnjë kartë identiteti, kontrata nuk mund të lidhet.

31



3.6 Konkurrenca e ndershme dhe e lirë

Jemi të përkushtuar për konkurrencën e ndershme dhe të lirë

PARIMI KORPORATIV

Konkurrenca e lirë dhe e ndershme mbrohet nga legjislacioni antitrust në fuqi në gjithë botën. Pajtueshmëria me këtë legjislacion siguron që të mos turbullohet pa nevojë konkurrenca në tregjet përkatëse, në dobi të të gjithë pjesëmarrësve në treg.

Janë të ndaluara, në veçanti, marrëveshjet dhe praktikatat e dakorduara midis konkurrentëve, të cilat kanë për qëllim të çojnë ose të ndikojnë në parandalimin ose kufizimin e konkurrencës së lirë.

Kjo përfshin në veçanti shkëmbimin e çmimeve dhe komponentëve të çmimeve, termave dhe kushteve, si edhe ndarjen e grupeve klientësh dhe territoreve dhe kufizimin e inovacionit. Për më tepër, ndalohet shkëmbimi i informacionit konkurrues të ndjeshëm. Gjithashtu ndalohet keqpërdorimi i pozicionit dominues në treg. Përveç kësaj, do të zbatohen në mënyrë të duhur procedurat e kontrollit të koncentrimit lidhur me bashkëpunimin dhe transaksionet.

Sjellja antikonkurrese jo vetëm mund të dëmtojë ndjeshëm reputacionin e Kompanisë,

Ne veprojmë ekskluzivisht në bazë të meritave dhe parimeve të ekonomisë së tregut, si edhe të konkurrencës së lirë dhe të hapur.

Neve na pëlqen të konkurrojmë, duke iu përmbajtur gjithmonë ligjeve, rregulloreve dhe parimeve etike.

por mund të çojë gjithashtu në gjopa të rënda, dëmshpërblime financiare dhe dënime të tjera.

Ne nuk lidhim asnjë marrëveshje antikonkurrese me konkurrentët, furnizuesit ose klientët. Nëse kompania jonë ka një pozicion dominues në treg, ne nuk do ta keqpërdorim.

Ne u përmbahemi dispozitave specifike antitrust për sistemet e shpërndarjes në marrëdhëniet tona me partnerët e autorizuar për aktivitetet e shpërndarjes.

KONTRIBUTI IM

Sa herë që vij në kontakt me konkurrentët, unë sigurohem që të mos jap dhe të mos marr asnjë informacion që mundëson nxjerrjen e konkluzioneve lidhur me sjelljen e tanishme ose të ardhshme të biznesit.

Gjatë diskutimeve ose në çdo kontakt tjetër me konkurrentët, unë shmang pyetjet që

mund të jenë relevante për konkurrencën e ndërsjellë.

SHEMBULL

Ju takoheni me të punësuarit e konkurrentëve në një konferencë tregtare dhe shkëmbeni ide me ta. Sigurohuni që të mos zbuloni sekrete tregtare, sidomos informacione të detajuara që mund të ndikojnë në konkurrencën e lirë dhe të ndershme. Ky informacion përfshin çmimet e produkteve dhe shërbimeve, pagesat dhe detajet strategjike.

33



3.7 Partnerët e biznesit, prokurimi dhe shitjet

Ne verifikojmë me kujdes se me kë bëjmë biznes

PARIMI KORPORATIV

Ne zgjedhim me kujdes furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe kompanitë partnere në bazë të kriterëve objektive, duke zbatuar parimet e konkurrencës. Ne punojmë me partnerët e biznesit vetëm në pajtim me kërkesat ligjore, rregullat dhe udhëzimet e brendshme.

Ne verifikojmë me kujdes integritetin e partnerëve të mundshëm të biznesit para se të hyjmë në marrëdhënie biznesi, duke zbatuar proceset dhe procedurat e kontaktit të përshkruara në rregulla dhe në politikë.

Kur blejmë ose shesim produkte dhe shërbime, ne përfshijmë departamentet përkatëse në proces në kohën e duhur dhe në pajtim me politikën në fuqi.

KONTRIBUTI IM

Unë interesohem për integritetin e partnerëve të mundshëm të biznesit para se të hyj në marrëdhënie biznesi, duke zbatuar proceset dhe procedurat e kontaktit të specifikuar në rregulla dhe në politikë. Unë nuk tregoj parapëlqim në favor të një furnizuesi, ofruesi të shërbimeve ose kompanie partnere pa arsye objektive dhe e promovoj konkurrencën.

Unë nuk blej asnjë produkt ose shërbim pa mbledhur më parë informacion lidhur me tregun dhe furnizuesit alternativë. Unë zbatoj udhëzimet e prokurimit në fuqi dhe e përfshij departamentin e prokurimit në një fazë të hershme para furnizimit të planifikuar dhe kryerjes së shërbimeve, në pajtim me proceset e zbatueshme të blerjes.

Unë sigurohem që të paguhen vetëm ato shërbime, që janë furnizuar me të vërtetë, dhe që pagesat të jenë proporcionale me shërbimet e furnizuara.

Gjithashtu, unë i përmbahem politikës përkatëse të kompanive të Grupit para vënies në punë.

SHEMBULL

Ju vini re se furnizuesi, ofruesi i shërbimeve ose kompania partnere do të angazhohet pa e përfshirë departamentin e prokurimit.

Kontaktoni departamentin e prokurimit ose një nga personat e kontaktit të përmendur në kapitullin "Mbështetja", për t'u siguruar që do të merret parasysh oferta më të favorshme për kompaninë.

3.8. Kontabiliteti dhe raportimi financiar

Jemi të përkushtuar për kontabilitet korrekt dhe raportim financiar të saktë

PARIMET KORPORATIVE

Ne u përmbahemi në mënyrë rigorozë dispozitave ligjore për kontabilitetin dhe raportimin financiar të saktë. Transparenca dhe korrektësia janë prioritetet tona, sepse çdo parregullsi mund të ketë pasoja të rënda si për kompaninë ashtu edhe për personin përgjegjës. Për këtë qëllim, ne informojmë rregullisht të gjithë pjesëmarrësit në tregun e kapitaleve për pozicionin tonë financiar dhe zhvillimet e biznesit. Ne publikojmë raportet tona financiare periodike saktësisht në pajtim me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.

KONTRIBUTI IM

Unë organizoj proceset në mënyrë që të siguroj se të gjitha të dhënat financiare të biznesit të futen në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur në sistemin e kontabilitetit. Në rast të pyetjeve lidhur me regjistrimin e saktë të të dhënave, unë do të kontaktoj mbikëqyrësin tim ose departamentin financiar.

SHEMBULL

Ju keni nevojë urgjente për pajisje të reja. Megjithatë, buxheti i departamentit tuaj për këtë vit fiskal tashmë është shpenzuar. Ju konsideroni mundësinë të prokuroni pajisjet dhe të postoni shpenzimet në vitin fiskal të ardhshëm kur buxheti juaj të rifreskohet.

Mos ndërmerrni kurrë një veprim të tillë. Regjistrimet duhet të bëhen gjithmonë në mënyrë korrekte. Publikimi i regjistrimeve të gabuara mund të ketë pasoja të rënda si për Kompaninë ashtu edhe për të punësuarin individual

3.9. Kontrolli i eksportit

Ne sigurojmë respektimin e të gjitha rregulloreve lidhur me tregtinë ndërkufitare

PARIMI KORPORATIV

Ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë sociale lidhur me përmbushjen e detyrimeve të kontrollit të eksportit dhe zbatimit të sanksioneve dhe detyrohemi shprehimisht të respektojmë legjislacionin përkatës.

Proceset dhe transaksionet ndërkufitare të biznesit mund t'u nënshtrohen ndalimeve, kufizimeve, kërkesave të miratimit ose masave të tjera të kontrollit sipas rregullave të kontrollit të eksportit. Këto mund t'u referohen partnerëve të biznesit, mallrave, shteteve, mjeteve financiare ose përdorimit të synuar. Kjo vlen si për teknologjitë dhe softuerët, ashtu edhe për mallrat dhe produktet. Për më tepër, kjo zbatohet edhe për transferimet ndërkufitare të përkohshme dhe transferimet teknike, për shembull, përmes postës elektronike ose cloud-it. Importe të caktuara mund t'u nënshtrohen rregullave të kontrollit të eksportit.

Ne sigurojmë pajtueshmërinë me rregulloret në fuqi për kontrollin e eksportit, si edhe me politikën e brendshme përkatëse.

KONTRIBUTI IM

Është përgjegjësia ime të verifikoj nëse jam në dijeni për informacionet dhe politikat e

ksportit. Në këtë mënyrë, unë verifikoj nëse puna ime e përditshme u nënshtrohet rregullave të kontrollit të eksportit.

38

Nëse unë vë që shkelen rregulloret e kontrollit të eksportit në fushën time të përgjegjësisë, do të marr menjëherë të gjitha masat e mundshme për të parandaluar ose korrigjuar shkelje të tilla.

Nëse kam dyshime, kërkoj këshilla nga personi i kontaktit për kontrollin e eksportit.

SHEMBULL

Keni ndërmend të hyni në marrëdhënie biznesi me një klient të mundshëm, i cili mund të jetë në listën e sanksioneve.

Sigurohuni t'u përmbaheni ligjeve në fuqi. Kontaktoni njësinë e kontrollit të eksportit për të koordinuar hapat e mëposhtëm.



JEMI QYTETARË KORPORATIVË TË MIRË

Ne mbajmë përgjegjësi për shoqërinë dhe sigurohemi që kompania jonë të kontribuojë në zhvillimin e saj të qëndrueshëm.



- 4.1 Komunikimi dhe marketingu
- 4.2 Lobimi politik
- 4.3 Marrëdhëniet me zyrtarët publikë
- 4.4 Donacionet dhe sponsorizimi social
- 4.5 Tatimet dhe taksat doganore
- 4.6 Mbrojtja e të dhënave
- 4.7 Siguria informatike
- 4.8 Përputhshmëria e produkteve
- 4.9 Mbrojtja e mjedisit natyror

4.1 Komunikim dhe marketing

Ne komunikojmë qartë dhe me respekt

PARIMI KORPORATIV

Ne sigurohemi që komunikimi ynë të jetë i qartë dhe konsistent me qëllim për të ruajtur besimin e klientëve, investitorëve dhe palëve të tjera të interesit. Para se të ndërmarrim dhe/ose të zbatojmë ndonjë masë komunikimi ose marketingu, kjo masë do të koordinohet së pari me departamentin përkatës. Kujdesi dhe respekti i ndërsjellë janë pjesë integrale e qenies sonë.

KONTRIBUTI IM

Unë nuk bëj asnjë deklaratë publike në emër të kompanisë dhe përcjell gjithmonë të gjitha kërkesat në Departamentin e Komunikimit. Në qoftë se bëj një koment në një ngjarje publike, tregtare ose kulturore ose në internet, e bëj të qartë se shpreh vetëm mendimin tim personal. Unë konsultoj udhëzimet e kompanisë për mediat sociale që të marr këshilla lidhur me sjelljen e duhur në mediat sociale.

SHEMBULL

Një i punësuar i Grupit ka bërë komente për media lidhur me shitjen e produkteve të një brendi tjetër të Grupit. Kjo jep përshtypjen se i punësuar po flet në emër të këtij brendi në cilësi zyrtare.

Kontakti të punësuarin dhe shpjegojni se vetëm njësitë e autorizuara mund të bëjnë komente zyrtare lidhur me kompaninë dhe produktet e saj. Përcillni komentet në njësinë përkatëse dhe kërkonte që ajo të verifikojë nëse ka nevojë për një përgjigje publike.

4.2 Lobimi politik

Ne përfaqësojmë pikëpamjet e kompanisë sonë në një mënyrë të përgjegjshme dhe të qartë

PARIMI KORPORATIV

Si anëtarë të shoqërisë, ne mund të promovojmë pozitën e kompanisë gjatë procesit të vendimmarrjes, siç janë ato lidhur me projektet legjislativë, përmes lobimit politik. Ne kryejmë lobimin politik në nivel qendror dhe në pajtim me parimet e hapjes dhe përgjegjësisë. Sigurisht, ndërveprimi ynë me partitë politike dhe grupet e interesit bazohet në parimin e neutralitetit. Nuk lejohet ndikimi i tepruar mbi politikën ose legjislacionin.

KONTRIBUTI IM

Unë nuk përpiqem të ndërhyj në vendimet politike në emër të kompanisë, nëse nuk jam i autorizuar për ta bërë këtë. Nëse jam i autorizuar për ta bërë këtë, unë e respektoj politikën e brendshme përkatëse në kryerjen e detyrave të mia.

SHEMBULL

Ju keni një të afërm, i cili punon në Ministrinë e Transportit dhe ai kërkon mendimin tuaj lidhur me një projektligj që do të ndikojë në industrinë e automobilave. Ju pyet edhe për qëndrimin e Grupit lidhur me këtë ligj. Mos komentoni.

Lobimi politik nga ana e kompanisë koordinohet ekskluzivisht në nivel qendror dhe zhvillohet në mënyrë të hapur dhe transparente. Pika e autorizuar e kontaktit për aktivitete lobimi është Departamenti i Marrëdhënieve të Jashtme.

4.3 Marrëdhëniet me zyrtarët publikë

Ne jemi të kujdesshëm kur kemi të bëjmë me zyrtarët publikë

PARIMI KORPORATIV

Duke pasur parasysh legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, ekziston një rrezik i lartë i korrupsionit kur kemi të bëjmë me zyrtarët publikë. Kjo merret parasysh në politikën tonë të brendshme, e cila përcakton kuadrin rregullator lidhur me benefitet. Në veçanti, ne nuk bëjmë asnjë pagesë për të lehtësuar ose përshpejtuar gjërat, d.m.th. pagesa për zyrtarët publikë, të cilët mund të lehtësojnë ose përshpejtojnë veprimet zyrtare të zakonshme ose rutinore.


KONTRIBUTI IM

Jam i vetëdijshëm/e vetëdijshme se ekziston një rrezik i lartë i korrupsionit kur punojmë me zyrtarët publikë. Për këtë arsye, jam familjarizuar me rregullat e veçanta në fuqi. Unë e kuptoj se jam në detyrë të konsultohem me Departamentin e Pajtueshmërisë në këtë drejtim.

SHEMBULL

Një organizatë e auditimit teknik kryen një auditim të jashtëm lidhur me marrjen e një certifikate të detyrueshme. Ju keni ndërmend të ftoni audituesit e organizatës për drekë.

Të punësuarit e organizatave të auditimit konsiderohen nëpunës publikë, sepse ata kryejnë funksione sovrane në emër të shtetit përmes procesit të certifikimit. Për këtë arsye, ju jeni në detyrë të përfshini paraprakisht departamentin e pajtueshmërisë. Ata do t'ju ndihmojnë të vlerësoni nëse personat në fjalë konsiderohen zyrtarë publikë.



4.4 Donacionet dhe sponsorizimet sociale

Ne angazhohemi për shoqërinë në shumë mënyra

PARIMI KORPORATIV

Ne bëjmë donacione, d.m.th. kontribute vullnetare pa marrë asnjë shërbim prapa nga marrësit dhe ofrojmë sponsorizime, d.m.th. kontribute të bazuara në marrjen e shërbimeve të dakorduara me kontratë për qëllime sociale, në mënyrë që të sigurojmë një ndikim pozitiv nga pikëpamja e reputacionit dhe perceptimit tonë publik. Për të shmangur konfliktet e interesit dhe për të siguruar një sjellje standarde brenda Kompanisë, donacionet dhe masat e sponsorizimit janë të lejueshme vetëm në kontekstin e kornizës ligjore përkatëse dhe në pajtim me rregullat e brendshme në fuqi të brendeve dhe kompanive të Grupit.

Donacionet dhe masat e sponsorizimit do të bëhen vetëm në pajtim me një proces transparent miratimi. Ne miratojmë pagesa dhe/ose benefite të tjera përveç parave të gatshme për qëllime shkencore, bamirësie, kulturore ose fetare. Përveç kësaj, ne bëjmë donacione ekskluzivisht për institucionet që njihen si bamirëse dhe/ose të privileguara nga pikëpamja e taksave.

KONTRIBUTI IM

Nëse më duket se një masë e caktuar sponsorizimi meriton mbështetjen tonë, unë do të vendos kontakt së pari me departamentet përkatëse të kompanisë, siç janë për shembull Departamenti i Komunikimit, Departamenti i Marrëdhënieve të Jashtme dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Donacionet do të bëhen në mënyrë transparente, d.m.th. qëllimi, marrësi i donacionit, dhe menaxhimi financiar duhet të jenë të dokumentuar dhe të verifikueshëm. Unë do të respektoj proceset e brendshme dhe kushtet e përgjithshme dhe prandaj nuk do të inicioj donacione që mund të dëmtojnë reputacionin e kompanisë sonë.

SHEMBULL

Ju jeni tifoz i një klubi të caktuar futbollit dhe dëshironi t'i ofroni mbështetje financiare në formë të sponsorizimit korporativ.

Vendimet e sponsorizimit merren në pajtim me të gjitha proceset e zbatueshme, në konsultim me të gjitha departamentet përkatëse dhe në bazë të kriterëve objektive. Nëse mendoni se klubi juaj ose ndonjë një marrës tjetër i sponsorizimeve nuk plotëson kriteret e kompanisë për sponsorizimin social, informoni departamentin e pajtueshmërisë.

4.5. Tatimet dhe taksat doganore

U përmbahem rregulloreve tatimore dhe doganore në mënyrë rigoroze

PARIMI KORPORATIV

Si një kompani globale, ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë sociale për të përmbushur detyrimet tona lidhur me tregtinë e jashtme, tatimet dhe taksat doganore. Prandaj në mbështesim shprehimisht pajtueshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

KONTRIBUTI IM

Unë dizajnoj strukturat dhe proceset e brendshme në mënyrë që të sigurohem se taksat dhe detyrimet që do të paguhen nga kompanitë e Grupit të llogariten saktë, në kohën e duhur dhe plotësisht, të deklarohen në raporte dhe të paguhen tek autoritetet përkatëse fiskale.

Nëse hasem me informacione që sugjerojnë një shkelje të rregulloreve tatimore ose doganore në fushën time të përgjegjësisë, unë do të bëj gjithçka që mundem për të parandaluar ose ndaluar këtë shkelje. Nëse kjo nuk është e mundur, unë do të kontaktoj personin e kontaktit në shërbimin tatimore ose doganor.

SHEMBULL

Ju jeni përgjegjës për regjistrimin e transaksioneve të caktuara të biznesit në raportet financiare, për shembull shpenzimet e përgjithshme, të tilla si kostot e mirëmbajtjes dhe kostot e prodhimit. Një projekt tejkalon disa parametra kontrolli në fillim të vitit financiar. Për këtë arsye, ju udhëzoheni që të regjistroni shpenzimet si kosto të mirëmbajtjes, megjithëse transaksioni padyshim ka të bëjë me një investim dhe për këtë arsye duhet të trajtohet si kosto të kapitalizuara të prodhimit.

Kryeni regjistrimin në pajtim me kërkesat ligjore. Të gjitha transaksionet e biznesit duhet të raportohen siç duhet në pajtim me ligjin tregtar dhe rregulloret tatimore pasi këto regjistra kontabël përbëjnë bazën e deklaratës tatimore. Gabimet kontabël mund të çojnë në deklarata tatimore të pasakta dhe në pasoja të rënda për kompaninë dhe të punësuarit përgjegjës në pajtim me legjislacionin tatimor dhe doganor .

4.6. Mbrojtja e të dhënave

Ne i trajtojmë të dhënat me kujdes



PARIMI KORPORATIV

Ne i kushtojmë shumë vëmendje trajtimit të përgjegjshëm, të sigurt dhe transparent të të dhënave. Ne mbledhim, përpunojmë, përdorim dhe ruajmë të dhënat personale ekskluzivisht në pajtim me kërkesat ligjore. Ne mbrojmë të dhënat personale të klientëve, të punësuarve, duke përfshirë ato të ish-të punësuarve dhe kandidatëve, dhe partnerëve, duke përfshirë furnizuesit dhe partnerët e zhvillimit.

KONTRIBUTI IM

Unë i trajtoj të dhënat personale në mënyrë konfidenciale dhe veprimet e mia janë të qarta dhe transparente. Unë integroj mbrojtjen e të dhënave në veprimet dhe proceset e mia, duke garantuar sigurinë e të gjitha të dhënave në fushën time të përgjegjësisë. Unë marr përgjegjësi dhe i kushtoj vëmendje shkëmbimit të sigurt të të dhënave nëpër gjithë zinxhirin e vlerave. Në rast dyshimi, unë e kontaktoj mbikëqyrësin tim ose departamentin përkatës të mbrojtjes së të dhënave.

SHEMBULL

Ju keni organizuar një seminar me pjesëmarrës të jashtëm dhe merrni të dhëna personale lidhur me seminarin. Një koleg kërkon që t'ia përcillni adresat e pjesëmarrësve, në mënyrë që t'u dërgojë komunikime komerciale rreth produkteve dhe shërbimeve tona.

Mos ia përcillni këtë informacion pa u konsultuar paraprakisht me organizatën për mbrojtjen e të dhënave. Si parim i përgjithshëm, të dhënat mund të përpunohen vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur.

4.7. Siguria informatike

Ne mbrojmë sistemet tona informatike

PARIMI KORPORATIV

Ne respektojmë sigurinë informatike dhe pajtohemi me rregulloret e zbatueshme të sigurisë informatike. Rregulloret e sigurisë informatike ofrojnë udhëzime për grupe të ndryshme të angazhimit dhe janë të rëndësishme për të gjithë të punësuarit.

KONTRIBUTI IM

Jam njohur me rregulloret e zbatueshme të sigurisë informatike dhe u përmbahem këtyre rregullave. Si pjesë e zinxhirit të sigurisë informatike, unë jap kontributin tim aktiv duke qenë vigjilent në çdo kohë dhe duke siguruar që aftësitë e mia themelore të sigurisë informatike të jenë gjithmonë të azhuruara.

SHEMBULL

Ju merrni një email nga dikush që pretendon të jetë një partner biznesi dhe kërkon informacione konfidenciale në lidhje me një projekt aktual. Ju besoni se përmbajtja e email-it është e pazakonshme dhe se vetë pyetja duket mashtruese.

Kontakttoni departamentin përkatës të sigurisë informatike për të sqaruar nëse dyshimi juaj është i saktë. Verifikoni me eprorin tuaj nëse informacionet konfidenciale mund t'u transferohen palëve të treta.

4.8. Përputhshmëria e produkteve

Ne e frymëzojmë botën me produktet tona

PARIMI KORPORATIV

Produktet tona frymëzojnë njerëz të panumërt në gjithë botën. Ne i japim përparësi të lartë pajtueshmërisë dhe sigurisë së produkteve tona. Ne mbajmë përgjegjësi për të siguruar që rreziqet për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe pronën e klientëve tanë ose të palëve të treta, që rrjedhin nga përdorimi i këtyre produkteve, të përjashtohen sa herë që të jetë e mundur.

Në pajtim me dispozitat ligjore, ne zhvillojmë produktet tona me teknologjinë më të fundit, duke marrë parasysh edhe detyrime të tjera, siç janë kërkesat shtesë të sigurisë që rrjedhin nga gjendja e njohurive shkencore.

Kjo sigurohet në mënyrë sistematike me anë të strukturave të vendosura dhe proceseve të qëndrueshme. Pas vendosjes së tyre në treg, produktet tona monitorohen vazhdimisht në terren në mënyrë që të merren menjëherë masat e duhura në rast të ndonjë mospërputhjeje. Ne nuk bëjmë asnjë kompromis në këtë drejtim.

KONTRIBUTI IM

U përmbahem të gjitha dispozitave relevante në punën time të përditshme. Unë vendos qëllime realiste. Nëse ka një konflikt qëllimesh, pajtueshmëria e produkteve tona ka gjithmonë një përparësi më të lartë, pavarësisht nga presioni i kohës dhe kostos. Për këtë arsye, unë i pranoj proceset tona të përcaktuara dhe i përmirësoj vazhdimisht. Së bashku, ne identifikojmë dhe adresojmë boshllëqet në procese për të përmbushur të gjitha angazhimet. Unë kontaktoj mbikëqyrësin tim ose ekipin e PCMS nëse kam pyetje ose shqetësime lidhur me pajtueshmërinë e produktit.

SHEMBULL

Një klienti ju kontakton për të raportuar probleme teknike me automjetin. Nuk jeni të sigurt nëse këto probleme janë pasoja e një gabimi pune nga ana e klientit ose kanë të bëjnë me një defekt prodhimi ose ndërtimi.

Sqaroni çështjen menjëherë. Është thelbësore që të sigurohemi se kompania jonë të zgjidhë çdo problem për të cilën është përgjegjëse. Për më tepër, gabimet nga ana e klientit mund të kërkojnë gjithashtu një përgjigje nga kompania jonë, duke përfshirë ndryshime në udhëzimet e përdorimit ose në trajnimin përkatës.

4.8. Mbrojtja e mjedisit

Ne jemi përgjegjës për mjedisin dhe qëndrueshmërinë



PARIMI KORPORATIV

Si një ndërmarrje tregtare globale, ne jemi përgjegjës për përputhshmërinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore të produkteve, lokacioneve dhe shërbimeve tona. Kompania jonë përpiqet të jetë një furnizues global i lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe një shembull sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Ne fokushohemi në teknologji miqësore ndaj mjedisit, të përparuara dhe efikase, të cilat i zbatojmë gjatë tërë ciklit jetësor të produkteve tona. Që nga fazat më të hershme të zhvillimit dhe prodhimit, ne menaxhojmë me kujdes burimet natyrore, zvogëlojmë vazhdimisht ndikimin në mjedis dhe u përmbahemi ligjeve dhe rregulloreve mjedisore.

Për më tepër, ne rivlerësojmë vazhdimisht pajtueshmërinë mjedisore të produkteve dhe proceseve të prodhimit, duke i optimizuar, nëse është e nevojshme. Ne jemi një anëtar i përgjegjshëm i shoqërisë dhe një partner i besueshëm në politikat mjedisore. Ne kërkojmë dialog me subjekte të ngjashme lidhur me konceptet e ardhshme të lëvizshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm nga pikëpamje e mjedisit.

KONTRIBUTI IM

Unë kujdesem për mjedisin në punën time dhe përdor burimet dhe energjinë në mënyrë ekonomike dhe efikase. Unë sigurohem që aktivitetet e mia të kenë ndikimin më të vogël të mundshëm në mjedis dhe të jenë në pajtim me ligjet dhe rregulloret mjedisore.

SHEMBULL

Ju vini re se pikon vazhdimisht nga rubineti i ujit që është instaluar në lavaman në zyrën tuaj. Kjo mund të konsumojë sasi të mëdha uji nëse nuk riparohet.

Ju raportoni defektin e rubinetit menjëherë te personat përgjegjës dhe tërhiqni vëmendjen e tyre në këtë problem.

MBËSHTETJA

Ne ofrojmë mbështetje lidhur me punën me Kodin e Sjelljes.

PARANDALIMI I SJELLJES SË PAPËRSHTATSHME, PIKAT E KONTAKTIT DHE SISTEMI I DENONCIMIT

Kodi ynë i Sjelljes siguron një kornizë detyruese për të vepruar me integritet dhe në pajtim me rregullat e Grupit tonë. Si të punësuar të Grupit, ne jemi përgjegjës për të respektuar parimet e Kodit tonë në mënyrë që të parandalojmë shkeljet e rregulloreve, duke parandaluar në këtë mënyrë dëmtime për kompaninë. Shkeljet e ligjit dhe politikës së brendshme hetohen menjëherë. Në varësi të ashpërsisë së shkeljes, kjo mund të ketë pasoja disiplinore, civile ose penale për të punësuarit. Sjellja e papërshtatshme e provuar mund të ndikojë gjithashtu në kompensimin financiar. Prandaj, ne do të flasim me mbikëqyrësin tonë ose të kërkojmë menjëherë këshillën e një eksperti nëse kemi pyetje ose shqetësime, ose nëse dyshojmë se rregulloret e brendshme ose të jashtme janë shkelur.

Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe përfaqësuesit e të punësuarve janë atje për të ofruar mbështetjen e nevojshme. Ne gjithashtu mund të kontaktojmë Zyrtarin e Pajtueshmërisë së kompanisë ose Këshilltarin e Pajtueshmërisë në çdo kohë në:

Adresën e postës elektronike: compliance@porsche.co.at

Për më tepër, ne mund të paraqesim raporte lidhur me shkeljet e rregulloreve përmes sistemit të denoncimit të Grupit Volkswagen.


Ne mund të japim emrin tonë ose mund të raportojmë në mënyrë anonime. Ne jemi të vetëdijshëm se sistemi i denoncimit i Grupit Volkswagen është përgjegjës për hetimin e raporteve lidhur me shkeljet serioze të rregulloreve.

Një shkelje e rëndë e rregulloreve është një shkelje e rëndësishme e vlerave tona etike, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Sjelljes. Po kështu, shkeljet e ligjeve ose rregulloreve ligjore që mund të ndikojnë ndjeshëm në reputacionin ose interesat financiare të Kompanisë konsiderohen gjithashtu shkelje të rënda të rregulloreve. Në të gjitha rastet e tjera, së pari duhet të kërkojmë këshilla nga mbikëqyrësi ynë, departamenti i burimeve njerëzore ose departamenti i pajtueshmërisë.

Menaxherët kanë një funksion të veçantë si modele të sjelljes. Vendimet që ata marrin për kompaninë duhet të kenë gjithmonë parasysh vlerat dhe rregulloret. Kjo përfshin raportimin e menjëhershëm të ndonjë dyshimi të arsyeshëm për një shkeljeje të rëndë.

Qëllimi i sistemit të denoncimit është të mbrojë kompaninë tonë, denonuesin dhe të gjithë personat që kontribuojnë në hetimin dhe përfundimin e sjelljes së papërshtatshme.

53



Diskriminimi kundër tyre konsiderohet si një shkelje serioze e rregulloreve.

Diskriminimi ndaj tyre konsiderohet një shkelje e rëndë e rregulloreve.

Në të njëjtën kohë, sistemi i denoncimit mbron interesat e personave të përfshirë. Supozohet që ata janë të pafajshëm derisa të provohen fajtorë. Puna e Sistemit të Denoncimit bazohet në procese unike dhe në përpunimin konfidencial dhe profesional të denoncimeve.

Në të njëjtën kohë, sistemi i denoncimit mbron interesat e personave të përfshirë. Supozohet që ata nuk anë fajtorë, derisa të vërtetohet fajësia e tyre. Funksionimi i Sistemit të Denoncimit bazohet në procese unike dhe në përpunimin konfidencial dhe profesional të denoncimeve.

Sistemi i denoncimit mund të kontaktohet në mënyrat e mëposhtme:

Të dhënat e kontaktit të zyrës hetimore:

Adresa postare: Zyra Hetimore Qendrore
Box 1717
38436 Wolfsburg, Gjermani

24/7 call-centar: +800 444 46300
+49 5361 946300

Adresa e postës elektronike: io@volkswagen.de

Kanali online për raportim: <https://www.bkms-system.com/vw>

(ky kanal mund të përdoret edhe për raportime anonime)

Personalisht: Ju lutemi të caktoni një takim paraprakisht duke shkruar një email në:
io@volkswagen.de

Për më tepër, avokatët me përvojë (jashtë Kompanisë) veprojnë si ndërmjetës neutralë për ne. Si përfaqësues ligjorë, ata janë përgjegjës për marrjen e raporteve lidhur me shkelje të mundshme të ligjeve ose rregullave të brendshme, si edhe me sjellje të tjera të dëmshme për Porsche Holding. Nëse është e nevojshme, dhe nëse identiteti i denoncuesit është i njohur, ata do të vendosin kontakt të drejtpërdrejtë nëse kanë nevojë për informacion. Pasi përgatitjet të kenë përfunduar, ndërmjetësuesit përcjellin gjithë informacionin e dakorduar me denoncuesin – në mënyrë anonime nëse ashtu dëshiron – në sistemin tonë të denoncimit për përpunim të mëtejshëm.

Detajet e kontaktit të ndërmjetësuesve:

Faqja e internetit: <https://www.ombudsmen-of-volkswagen.com>

Informacione të mëtejshme lidhur me sistemin e denoncimit të Grupit Volkswagen, ndërmjetësuesit dhe kanalin përkatës të raportimit të jashtëm (nëse është e aplikueshme) janë në dispozicion në faqen e internetit <https://vvv.volkswagenag.com/en/group/compliance-and-risk-management/vhistleblowersystem.html>.

VETËTESTIM PËR VENDIMMARRËSIT

Nëse nuk jam i/e sigurt në çdo kohë nëse sjellja ime përputhet me parimet e përshkruara në Kodin tonë të Sjelljes, duhet t'i bëj vetes pyetjet e mëposhtme:

1. A kam marrë parasysh të gjitha gjërat relevante dhe i kam konsideruar mënyrë korrekte? (testi i përmbajtjes)
2. A jam i/e sigurt se vendimi im është brenda kufijve të kërkesave ligjore dhe të kompanisë? (testi I ligjshmërisë)
3. A do të mbroj vendimin tim kur të zbulohet? (testi për mbikëqyrësin)
4. A jam dakord që të gjitha rastet e tilla të trajtohen në të njëjtën mënyrë në gjithë kompaninë? (testi i universalitetit)
5. A mendoj akoma se vendimi im është i drejtë kur kompania ime duhet ta justifikojë atë publikisht? (testi publik)
6. A do të pajtohesha me vendimin time nëse do të më prekte mua? (Testi i përfshirjes)
7. Çfarë do të thoshte familja ime për vendimin tim? (Mendimi i të tjerëve)

Nëse përgjigja ime për pyetjet 1–6 është "po" dhe përgjigja ime për pyetjen 7 është pozitive, ka shumë të ngjarë që sjellja ime të jetë në pajtim me parimet tona. Nëse pyetjet mbeten pa përgjigje ose nëse kam ndonjë dyshim, duhet të kontaktoj ndonjë nga personat e kontaktit të përmendur në këtë kapitull.

© VOLKSWAGEN AKTIENGESELLSCHAFT

Integriteti dhe pajtueshmëria në Grup
Letterbox 1717
38436 Wolfsburg
Gjermani

Versioni 3.0 | Janar 2024